

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ
NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI
PUBLIK I FURNIZIMIT**

Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 22.10.2020

Kontratë Nr._____.

PJESA E PARË

E lidhur sot me datë_____, në _____

Nga palët në Kontratë:

Furnizuesi i shërbimit publik_____, i regjistruar si person juridik sipas legjislacionit në fuqi, sipas vendimit Nr._____, datë_____të QKR, pajisur me Numër Identifikimi pranë organeve tatimore _____dhe me Licensën për Furnizimin me gaz natyror dhe i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr._____, datë_____, në adresën zyrtare:_____Shqipëri, përfaqësuar nga personi i autorizuar Z./Zj._____, identifikuar këtu e më poshtë si Furnizuesi.

Dhe

Klienti fundor që përfiton nga shërbimi publik i furnizimit _____, përfaqësuar _____(Emri, atësia, dhe Mbiemri i Përfaqësuesit Ligjor të Klientit) në adresën: Rruga _____, Ndërtesa____, Ap.____, Njësia Administrative Nr...; Qytet/Fshat_____, tel nr._____, identifikuar nga dokumenti i identifikimit të tij: Nr. i Pasaportës/kartë identiteti.

Pika e lidhjes ne rrejtin e Gazit Natyror.....

Adresa e Klientit Fundor për shërbimin e dërgimit të faturës.....

Nr. i tel adresa e e-mail (nëse ka).....

Palët bien dakort që Pjesa e Dytë “Termat dhe Kushtet” është pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

FURNIZUESI

KLIENTI

PJESA E DYTË
TERMAT DHE KUSHTET

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate konsiston në ofrimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në mbështetje të neneve 75, 89, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, gjithashtu dhe Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 3
Objekti i kontratës

3.1 Objekti i kësaj kontrate është furnizimi me gaz natyror nga ana e Furnizuesit të Licensuar i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, dhe detyrimi i klientit për të paguar gazin natyror të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate.

3.2 Furnizimi me gaz natyror i klientëve fundorë, nga Furnizuesi i Licensuar në pikën e lidhjes se sistemit e kërkuar nga klienti fundor me këto parametra teknikë:

- me sasia e kërkuar _____m³ / k W h
- me Presion _____Bar
- Cilësia sipas raportit të prodhuesit

Neni 4
Dispozita të përgjithshme

4.1 Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit me gaz natyror. Klienti nuk mund t’i japë apo shesë gaz natyror klientëve të tjerë nga pika e tij e lidhjes.

4.2 Furnizuesi është i detyruar të mbrojë dhe të mos nxjerrë të dhënat personale të Klientit, konform Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave Personale” të ndryshuar. Të dhënat personale të Klientit mund të jepen nga Furnizuesi në rastet e mëposhtme:

- Me pëlqimin e Klientit;
- Në rast të respektimit të detyrimeve kontraktuale të Furnizuesit në lidhje me përmbushjen e shërbimit të shpërndarjes së faturave të gazit natyror dhe/ose arkëtimin e detyrimeve.
- Në zbatim të legjislacionit në fuqi.

4.3 "Furnizuesi është i detyruar që, kur mbledh të dhëna personale, për qëllim të kësaj kontrate, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave bazuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887/2008 dhe, furnizuesi është përgjegjës në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej, referuar gërmës d) të pikës 1 të nenit 5, të po këtij ligji.

Neni 5 Lidhja e kontratës

5.1 Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me gaz natyror çdo person jo debitor ndaj furnizuesit, që ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të gazit natyror dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në ligjin e Sektorit të Gazit natyror.

5.2 Të drejtën e furnizimit nga furnizuesi i shërbimit publik e ka edhe çdo klient i cili ka përfituar statusin e "klientit në nevojë", sipas përcaktimeve të nenit 97 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit natyror" dhe që është rregjistruar pranë Operatorit si i tillë.

5.3 Klienti fundor që kërkon lidhjen e kontratës me furnizuesin e ngarkuar me shërbimin publik të furnizimit duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim pranë çdo përfaqësit të Furnizuesit nga i cili merr shërbimin e furnizimit, shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në këtë kontratë.

5.4 Furnizuesi pasi ka kontrolluar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nënshkruan kontratën me Klientin brenda 15 ditëve kalendarike, nga marrja e kërkesës së aplikuesit.

5.5 Nëse kërkesa e aplikuesit nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e plotë, Furnizuesi brenda 7 ditësh kalendarike, do të njoftojë me shkrim, aplikuesin për mangësitë e konstatuara. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda 7 ditësh kalendarike nga momenti i njoftimit. Kërkesa do refuzohet në rast mosplotësimi të këtij dokumentacioni. Furnizuesi duhet të njoftojë, me shkrim aplikuesin, në adresën e përcaktuar nga aplikuesi në kërkesën për furnizim, në çdo rast për pranimin ose jo të kërkesës së tij.

5.6 Për një objekt i cili është furnizuar me parë me gaz natyror, Furnizuesi do të sigurojë lidhjen e kontratës së re, brenda 7 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës nga ana e subjektit të interesuar.

Neni 6

Pezullimi dhe përfundimi i kontratës

6.1 Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:

6.1.1 Me kërkesë të Klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në nenin 6.2.

6.1.2 Me inisiativën e Furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e Klientit të detyrimeve/kushteve thelbësore të kontratës, për të cilat njoftohet me parë me shkrim. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit rastet si më poshtë:

- a- Nëse Klienti nuk paguan detyrimet e gazit natyror duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së gazit natyror.
- b- Nëse provohet nga Furnizuesi që Klienti merr gaz natyror në mënyrë të paligjshme.
- c- Nëse Klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses Furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësive dhe instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës së tij.
- d- Nëse klienti dhe pasi ka marrë njoftim me shkrim nga furnizuesi në afatet e parashikuara në ligj, për ndryshimin e kushteve të kontratës, të miratuara nga ERE, nuk merr masa për zbatimin e tyre.

6.1.3 Furnizimi me gaz natyror i klientëve që kanë përfituar statusin e “klientëve në nevojë”, do të ndërpritet vetëm sipas kushteve të parashikuara në Rregulloren e miratuar nga ERE, sipas nenit 97 të Ligjit nr. 102/2015 ”Për Sektorin e Gazit Natyror”.

6.2 Nëse Klienti kërkon të pezullojë/mbyllë kontratën e Furnizimit me Gaz natyror, ai do të njoftojë me shkrim Furnizuesin 15 ditëve kalendrike përpara, dhe do të likuidojë të gjitha detyrimet përkundrejt Furnizuesit jo më vonë se 30 ditë nga mbyllja apo pezullimi i kontratës. Klientit do t'i jepet konfirmimi për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës (mandati përkatës i arkëtitimit nëse aplikohet nga Furnizuesi). Klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim që mund të rezultojë ndaj Furnizuesit pas përfundimit të afatit 30 ditor pas depozitimit të kërkesës (kohë në të cilën janë shlyer të gjitha detyrimeve financiare).

6.3 Klienti mund të bëjë kërkesë për riaktivizimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror, pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit, i cili do të garantojë furnizimin me gaz natyror brenda 48 orëve, nga momenti i depozitimit të kërkesës.

6.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror, Furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e gazit natyror në pikën e lidhjes, nëpërmjet operatorit të shpërndarjes. Me ndërprerjen e lidhjes, Furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vuloset pika e lidhjes, duke u përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.5 Klienti është përgjegjës për ekzekutimin e detyrimeve që lidhen me konsumin e gazit natyror deri në momentin e përfundimit të kontratës. Në çdo rast klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim ndaj furnizuesit pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 5.2.

Neni 7

Detyrimet e furnizuesit

7.1 Furnizuesi, në zbatim të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror” ka detyrimin të furnizojë klientët me gaz natyror, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

7.2 Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara në kontratë, informon klientët, në faturat përkatëse, për:

- a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të gazit natyror;
- b) konsumin dhe kostot aktuale të gazit natyror, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të gazit nga ana e klientëve;
- c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;
- d) procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ankesave mes furnizuesit dhe klientit.
- f) të bëj publike, duke reklamuar në zyrat e përfaqësive të tij, dhefaqen e internetit procedurat për pezullimin dhe ndërprjen e kontratës së furnizimit me gaz natyror.
- e) të njoftojë me shkrim, klientin fundor në rast të mospagimit si dhe masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit sipas dispozitave të Ligjit nr. 105/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë” i ndryshur.
- g) Furnizuesi do të sigurojë aksesin online të faturës së konsumit për çdo Klient fundor duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të Klientit dhe faturimit.

Neni 8

Te drejtat e klientit fundor

8.1. Klienti fundor ka të drejtë:

- a) të furnizohet me gaz natyror në përputhje me kushtet e vendosura në këtë kontratë;
- b) të paraqesë ankesë pranë përfaqësive të furnizuesit dhe pranë ERE-s, nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë;
- c) të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;

- d) të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit në përputhje me nenin 6 të kësaj kontrate;
- e) të drejtën për të zgjedhur dhe ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi ka ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të gazit natyror;
- f) të marrë informacion të plotë, me shkrim, për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të gazit natyror;
- g) të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;
- h) të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit;
- i) të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, të cilat kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi;
- j) të informohet, pa kosto shtesë, për konsumin e tij dhe kostot respektive të gazit natyror, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur klienti;
- k) Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

Neni 9 Detyrimet e klientit fundor

9.1 Klienti fundor ka këto detyrime ndaj Furnizuesit :

- a) të paguajë për gazin natyror, në përputhje me kushtet e kontratës;
- b) t'i mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të gazit natyror pasi është njoftuar me shkrim 48 orë më parë.
- c) të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit.
- d) Klientet fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, në përputhje me vendimet e ERE-s e cila, vendos për përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

Neni 10 Çmimi i gazit natyror

10.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e gazit natyror, çmimi i gazit natyror përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të gazit natyror.

10.2 Ndryshimet e çmimit të gazit natyror bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakort që çdo ndryshim i çmimit i bërë me vendim të ERE –s, do të aplikohet automatikisht në kontratë.

10.3 Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 5 ditë kalendarike përpara aplikimit.

Neni 11

Leximi i matësit dhe faturimi i gazit natyror

11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të gazit natyror të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit, si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të gazit natyror, brenda 10 ditëve nga data e leximit.

Çdo faturë e gazit natyror duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të Klientit;
- Data e leximit;
- Periudha e faturuar;
- Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;
- Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Data limit e pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar;
- Vlera e detajuar e debisë së Klientit;
- Informacione të nevojshme për Kujdesin ndaj Klientit (përfshirë website i kompanisë, numrat e telefonit, e-mail për ankesat, për defektet si të drejtën për të paraqitur ankesë pranë ERE).

Neni 12

Faturimi i gazit natyror gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

12.1 Në rast se të dhënat e aparatit të matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese, nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

12.2 Nëse Furnizuesi nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 12.1 për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero.

12.3 Në rast të konstatimit të pasaktësive në matje, palët do të rregullojnë efektet në zbatim të parashikimeve të Kodit të Matjes dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 13

Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të gazit natyror jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.

13.2 Klienti mund të zgjedhë mënyrën e pagesës së faturës mujore të gazit natyror me një nga mundësitë që Furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në Zyrat e Furnizuesit, bankave, zyra postare, apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare).

13.3 Të gjitha pagesat sipas kushteve të kësaj Kontrate duhet të përmbajnë të dhënat siç janë numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e gazit natyror, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin e klientit. Sipas Marrëveshjes me Klientin faturat mund të dërgohen:

- Klientit në adresën e përcaktuar në kontratë;
- Në adresë të një personi të tretë, i cili është përcaktuar si pages nga Klienti sipas pëlqimit të tij.

13.4 Në të gjitha rastet, Klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave sipas kushteve të kësaj kontrate. Në rast se Klienti ndërron vendbanim pa njoftuar, ai është përgjegjës për mos pagesat e faturave të gazit natyror.

13.5 Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga Klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, Furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të Klientit, dhe shuma përkatëse, të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të Klientit.

Neni 14

Kamatëvonesa për pagesë të vonuar

Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 13, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.

Neni 15

Pasojat e mospagesës

15.1 Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas nenit 13.1, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit, 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit.

15.2 Nëse Klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror sipas nenit 12, atëherë Furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me gaz natyror sipas pikës 6.1.2, duke njoftuar me shkrim klientin.

Neni 16

Ankimi për faturimin dhe kushtet e furnizimit të gazit natyror

16.1 Klienti Fundor ka të drejtë të paraqesë një ankim pranë Furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të Furnizuesit që lidhet me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, me shkrim, me gojë, me telefon (Call Center) ose në rrugë elektronike.

16.2 Furnizuesi do të trajtojë çdo ankesë në përputhje me “Rregulloren e Trajtimit të Ankesave, të hartuar nga furnizuesi dhe të miratuar nga ERE. Kjo Rregullore bëhet publike në zyrat ku bëhen pagesat e gazit natyror, apo në Zyrat e Kujdesit ndaj Klientit dhe në faqet elektronike të Furnizuesit apo të ERE-s.

16.3 Në rast se Furnizuesi nuk i kthen përgjigje për ankesën Klientit fundor brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e mësipërme, apo nëse Klienti fundor nuk është dakort me përgjigjen e dhënë prej Furnizuesit, atëherë ai ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë ERE- s, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloret përkatëse të ERE-s. Ankesa në ERE mund të paraqitet jo më vonë se 12 muaj pas marrjes dijeni nga klienti të përgjigjes së trajtimit të ankesës nga furnizuesi në adresën e përcaktuar në këtë kontratë.

16.4 Klienti fundor mund të kundërshtojë në çdo kohë faturën e lëshuar nga Furnizuesi por jo më vonë se 1 vit nga data e lëshimit të saj, si në rast kur dyshon në saktësinë e faturimit, gabime të tjera të konstatuara në faturë apo pasaktësi në sistemin e matjes.

16.5 Në rast se pas verifikimeve të Furnizuesit, rezulton se konsumatori është mbifaturuar atëherë Furnizuesi:

- i. anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrektuar,
- ii. në rast se është kryer pagesa, realizon kompensimin përkatës në faturën e Klientit brenda 3 muajve pasardhës.

Në rast të mos kompensimit brenda afatit të përcaktuar me sipër, Furnizuesi duhet të kompensojë Klientin, me një penaltet 0.1 % në ditë, për çdo ditë vonesë, mbi vlerën e diferencës për tu korrigjuar, e zbritshme në faturën pasardhëse.

16.6 Për faturat e kontestuara nga Klienti që rezultojnë me faturime dukshëm më të mëdha se faturimet mesatare mujore të tij, (të krahasueshme ose më shumë se dyfishi i faturimit mesatar mujor të së njëjtës periudhë), Furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përshpejtuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.

16.7 Për faturat e ankimuara nga Klienti, nuk do të ndërpritet furnizimi me gaz natyror deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës për këtë faturë nga Furnizuesi.

Neni 17

Instalimi dhe pronësia

17.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon tek Klienti Fundor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit, sistemin e matjes së gazit natyror dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për Lidhjet e Reja”. Matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe DPM-ja, ose nga personi juridik i autorizuar prej saj.

17.2 Klasa e saktësisë së matësve të gazit natyror përcaktohet në Kodin e Matjes, miratuar nga ERE.

17.3 Në veprimtarinë e matjes së gazit natyror mund të implementohen sisteme matëse inteligjente të klientët fundorë.

17.4 Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matjeje shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

17.5 Klienti është përgjegjës për cilësinë, kushtet teknike dhe ato të sigurimit teknik që lidhen me kryerjen e instalimeve të gazit natyror brenda objektit apo banesës së tij.

17.6 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të gazit natyror të vendosur brenda kufijve të pronës së tij.

Neni 18

Kontrolli i sistemit matës

18.1 Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

18.2 Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit ose me kërkesë të Klientit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo subjektit të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në “Kodin e Matjes”. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

18.3 Kontrolli i sistemit të matjes bëhet në prezencë të Klientit fundor, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon Sektorin e Gazit natyror.

18.4 Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuesit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë

verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

18.5 Në rast të ndërhyrjeve në sistemin e matjes nga Klienti, me qëllim të manipulimit apo mosrregjistrimit të saktë të gazit së konsumuar, ndaj tij do të procedohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

18.6 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përlllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në “Kodin e Matjes”.

18.7 Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, nga ana e Operatorit të Rrjetit merren masa për zëvendësimin e sistemit të matjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Furnizimi dhe karakteristikat e gazit natyror

19.1 Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të gazit natyror. Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e gazit natyror në rastet e mëposhtme:

- a. Për shkaqe të forcës madhore -ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit.
- b. Ndërprerje për shkak të urdhrave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
- c. Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave;
- d. Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit;
- e. Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes.

19.2 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ndërprerjet parashikuara në gërmat “a”, “b”, “c”, të këtij neni. Për ndërprerjet e parashikuara në gërmat “d” dhe “e” të pikës 19.1, Furnizuesi është i detyruar të respektojë normat dhe procedurat e përcaktuara në “*Rregullore për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të Gazit Natyror*”.

19.3 Në rast të mosrespektimit të normave dhe procedurave të përcaktuara në “*Rregullore për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të Gazit Natyror*”, Furnizuesi është përgjegjës për kompensimin e Klientit, sipas kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me procedurën dhe masën e kompensimit të përcaktuara në Rregulloren e mësipërme.

19.4 Në asnjë rast përfitimi i kompesimit nga ana e Klientit, kur plotësohen kushtet e nenit 16.5, nuk e përjashton të drejtën e Klientit për të kërkuar në rrugë gjyqësore dëmin efektiv të shkaktuar.

19.5 Furnizuesi do të respektojë parametrat e cilësisë së tensionit, sipas “Kodit të Shpërndarjes së Gazit natyror” dhe parametrat e vendosura në “Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të Gazit Natyror”.

19.6 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet që mund ti shkaktohen Klientit për shkak të devijimeve të tensionit në kundërshtim me normat e furnizimit të përcaktuara “Rregullore për përcaktimin e kritereve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të Gazit Natyror” dhe akteve të tjera në fuqi, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë apo me faj të tij.

19.7 Përcaktimi i dëmit efektiv të shkaktuar Klientit në rastet e pikës 19.6, bëhet me marrëveshje midis palëve ose në rrugë gjyqësore.

Neni 20

Detyrime të përbashkëta

20.1 Pasi të dy palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i Furnizuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në prezencë të Klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elementë të tjerë të sistemit të matjes si dhe regjistron në kontratë:

- Vulën e Matësit _____
- Numrin e serisë së matësit _____
- Leximin aktual të tregimit të matësit _____
- Si dhe një skemë të thjeshtë të furnizimit me gaz natyror përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit si dhe kufijtë e përgjegjësisë së Klientit.

20.2 Çdo ndryshim i mëvonshëm i elementeve të përcaktuara në nenin 18 dhe 19 do reflektohen në kontratë.

Neni 21

Ndryshimet e kontratës

21.1 Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Publik të Furnizimit me gaz natyror, janë subjekt i ndryshimeve nga ana e ERE-s, sipas të njëjtës procedurë të miratimit të tyre.

22.2 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga ERE dhe kushtet e saj bëhen të aplikueshme automatikisht për të gjithë Klientet Fundor, që kanë të lidhur një kontratë furnizimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

22.3 Në rast të kontestimit të këtyre kushteve nga ana e Klientit Fundor, ai mund të heqë dorë nga Kontrata pa asnjë penaltet, pasi ka ekzekutuar më parë të gjitha detyrimet.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, dhe me pas gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 23
Legjislacioni i zbatueshëm

Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo kontratë, do të zbatohen akte të tjera rregullatore që lidhen me furnizimin si dhe dispozitat e Kodit Civil.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.